

# ORIENTIME BARITORE MBI TREFIKIMIN E PERSONAVE


*“Vallë a s’është agjërimi që unë zgjodha:  
t’i këputësh verigat e padrejtësisë,  
t’i zgjidhësh leqet e zgjedhës,  
t’i lëshosh në liri të ndrydhurit,  
të copëtosh çdo zgjedhë?”*

Isaia 58





**ORIENTIME BARITORE  
MBI TREFIKIMIN E  
PERSONAVE**



# TREGUESI

---

<b>PARATHËNIE</b>	<b>5</b>
<b>HYRJE</b>	<b>7</b>
<b>PËRKUFIZIM</b>	<b>10</b>
<b>REALITETE DHE PËRGJIGJE</b>	<b>12</b>
<b>SHKAQET E TRAFIKIMIT</b>	<b>13</b>
1. KTHIMI NË MALL DHE SHFRYTËZIMI	13
2. KËRKESA	17
<b>NJOHJA E TRAFIKIMIT</b>	<b>20</b>
3. NGURRIMI PËR TË NJOHUR TRAFIKIMIN	20
4. IDENTIFIKIMI DHE REFERIMI I TRAFIKIMIT	24
<b>DINAMIKAT E TRAFIKIMIT</b>	<b>27</b>
5. LIDHJA ME BOTËN E BIZNESIT	27
6. KUSHTET E PUNËS DHE RRJETI I FURNIZIMIT	29
7. TRAFIKIMI DHE KONTRABANDIMI I MIGRANTËVE	32
<b>PËRGJIGJET NDAJ TRAFIKIMIT</b>	<b>35</b>
8. FORCIMI I BASHKËVEPRIMIT	35
9. MBËSHTETJA E TË MBIJETUARVE TË TRAFIKIMIT	38
10. NXITJA E RIINTEGRIMIT	42
<b>PËRFUNDIM</b>	<b>44</b>
<b>LUTJE</b>	<b>45</b>



# PARATHËNIE

---

Papa Françesku nuk e ka fshehur kurrë shqetësimin e tij në lidhje me dukurinë e trafikimit të personave, që korr miliona viktime – burra, gra e fëmijë –, të cilët mund të numërohen ndër personat më të dehumanizuar dhe të skartuar kudo në botën e sotme. Trafikimi i personave, thotë Ati i Shenjtë, është një "mundim mizor"<sup>1</sup>, një "varrë absurde"<sup>2</sup> dhe një plagë "bashkëkohore në trupin e njerëzimit"<sup>3</sup>.

Në fillim të vitit 2015, Papa Françesku ia ka kushtuar mesazhin e vet të përvitshëm për Ditën Botërore të Paqes, luftës kundër trafikimit të personave: "Jemi përballë një dukurie botërore që i tejkalon kompetencat e një bashkësie apo kombi të vetëm" dhe prandaj "nevojitet një mobilizim me përmasa të krahasueshme me ato të vetë dukurisë"<sup>4</sup>.

Në shtator 2015, Ati i Shenjtë, duke iu drejtuar Kombeve të Bashkuara, pohonte se të këqijave si "trafikimi i qenieve njerëzore, trafikimi i organeve, shfrytëzimi seksual i djemve dhe vajzave të vogla, puna e detyruar, përfshirë prostitucionin" nuk mund t'u jepet përgjigje vetëm me "angazhime të marrura përsipër solemnisht". "Duhet të kemi kujdes që institucionet tona", ashtu si edhe të gjitha përpjekjet tona, "të jenë realisht efikase në luftën kundër të gjitha këtyre fatkeqësive"<sup>5</sup>.

*Orientimet Baritore* mbi trafikimin e personave kanë qëllim të japin një çelës *leximi* të fenomenit dhe një *kuptim* që arsyetojnë dhe mbështesin një luftë të nevojshme dhe kohëgjatë.

---

**1** Papa Françesku, *Mesazhi drejtuar pjesëmarrësve në konferencën e OSBE-së*, 3 prill 2017.

**2** Papa Françesku, *Angelus*, 30 korrik 2017.

**3** Papa Françesku, *Fjalim drejtuar pjesëmarrësve në Konferencën Ndërkombëtare mbi Tregtinë e Personave Njerëzore*, 10 prill 2014.

**4** Papa Françesku, *Mesazhi për Ditën Botërore të Paqes*, 1 janar 2015.

**5** Papa Françesku, *Fjalim drejtuar anëtarëve të Asamblesë së përgjithshme të Organizatës së Kombeve të Bashkuara*, 25 shtator 2015.

## PARATHËNIE

Seksioni Migrantët dhe Refugjatët (M&R) i ka filluar veprimtarinë e veta më 1 janar 2017. E ka themeluar Papa Françesku, i cili, *ad tempus*, e ka marrë personalisht udhëheqjen e tij. Seksioni ka detyrën të përballojë temën e trafikimit të personave së bashku me çështjet përkatëse të migrantëve dhe refugjatëve. Misioni i tij është ai që të ndihmojë Ipeshkvinjtë e Kishës Katolike dhe ata që janë vënë në shërbim të këtyre grupeve vulnerabel.

Për të përballuar problemin e trafikimit dhe të skllavërisë së qenieve njerëzore, gjatë vitit 2018, Seksioni M&R ka organizuar dy konsulta me ipeshkvinj, koordinatorë baritorë, kërkues, operatorë profesionistë dhe përfaqësues të organizatave të angazhuara në këtë sektor. Pjesëmarrësit kanë shkëmbyer mes tyre përvoja dhe këndvështrime, duke përballuar aspektet e rëndësishme të kësaj dukurie. Është analizuar edhe përgjigjja globale e Kishës, duke specifikuar pikat e saj të forta dhe dobta, mundësitë politike e baritore, ashtu si edhe nevojën për një fuqizim të koordinimit në nivel botëror.

Ky proces, që ka zgjatur gjashtë muaj, u ka dhënë jetë *Orientimeve Baritore* mbi tregtinë e personave, të miratuara nga Ati i Shenjtë, të cilat kanë qëllimin të orientojnë punën e Seksionit M&R dhe të bashkëpunëtorëve të tij. *Orientimet* u drejtohen dioqezave, famullive dhe kongregatave rregulltare, shkollave dhe universiteteve, organizatave katolike dhe organizatave të tjera të shoqërisë civile si dhe çfarëdo grupi tjetër të gatshëm për t'u angazhuar në këtë fushë. Përveçse japin linja aktualizimi në nivel lokal dhe bashkëpunimi në largësi, *Orientimet* japin edhe nxitje për homeli, programe formuese dhe komunikimi mediatik.

Këto *Orientime Baritore* janë të disponueshme në format dixhital në: <https://migrants-refugees.va/it/tratta-di-esseri-umani-e-schiavitu/> në gjuhë dhe formate të ndryshme.

Seksioni M&R uron që, në fushën formuese, komunikative dhe operative, të gjithë të angazhohen energjikisht me qëllim që të parandalojnë dhe të zhdukin trafikimin e personave, duke lejuar të frymëzohen nga reflektimi, nga lutja dhe nga mësimet e Papës Françesku.

**Fabio Baggio C.S. dhe Michael Czerny S.I.**

Nënskretarë

Qyteti i Vatikanit, 2019



# HYRJE

---

**1** Gjatë audiencës papnore<sup>1</sup> në fillim të vitit 2018, një e re e mbijetuar nga trafikimi i personave (TP) shtroi një pyetje: "mendoj për vendin tim, për të rinjtë e shumë të që gënjehen me premtime të rreme, mashtrohen, skllavizohen, prostituohen. Si do të mund t'i ndihmonim këta të rinj që të mos bien në kurthin e iluzioneve dhe në duart e trafikantëve?"<sup>2</sup>.

**2** Papa Françesku e mori vërtet seriozisht atë pyetje dhe u përgjigj: "Siç the, duhet bërë që të rinjtë të mos bien 'në duart e trafikantëve'. Sa e tmerrshme është të kuptojmë se shumë viktime të reja më parë janë braktisur nga familjet e tyre, janë konsideruar si mbeturinë e shoqërisë së tyre! Pastaj shumë prej tyre janë përfshirë në tregti prej vetë të afërmeve të tyre dhe prej të ashtuquajturve miq. Ka ndodhur edhe në Bibël: mos harroni se vëllezërit e tuj më të rritur e shitën Jozefin e ri si skllav, dhe kështu ai u çua në Egjipt!" (krh. Zan 37.12-36). Pyetja e të resë dhe përgjigjja e Atit të Shenjtë përmbledhin motivimet dhe shpirtin e këtyre *Orientimeve Baritore mbi Trafikimin e Personave*.

**3** "Trafikimi i personave është një plagë në trupin e njerëzimit bashkokohor, një plagë në trupin e Krishtit"<sup>3</sup>. Kjo padi e dhimbshme e Papës Françesku në prill 2014 përbën një thirrje urgjente në lidhje me një prej aspekteve më të errëta të historisë bashkëkohore, një dukuri që, në mënyrë tragjike e të turpshme, vazhdon edhe sot. TP bën viktime miliona persona në të gjithë botën dhe sot përbën një realitet të përhapur dhe të rrezikshëm të shumë sektorëve ekonomikë, në veçanti në punën shtëpiake, në industrinë manifakturore, në sektorin e hotelarisë dhe në bujqësi. TP shfaqet në mënyra dhe situata të ndryshme: shfrytëzimi seksual, martesat

---

**1** Françesku. *Fjalë drejtuar pjesëmarrësve në Ditën IV Botërore të Lutjes dhe Reflektimit kundër Tregtisë së Personave*, 12 shkurt 2018.

**2** Me fjalën "trafikant", në këto *Orientime Baritore*, kuptohet një kriminel që rekruton, transporton ose shfrytëzon personat në kontekstin e tregtisë. Në këtë merret terminologjia e propozuar nga versioni italian i *Protokollit plotësues të Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër kriminalitetit të organizuar transnacional për të parandaluar, shtypur dhe ndëshkuar tregtinë e personave, veçanërisht të grave dhe fëmijëve (Protokolli i Palermos)*.

**3** Papa Françesku, *Fjalim drejtuar pjesëmarrësve në Konferencën Ndërkombëtare mbi Tregtinë e Personave Njerëzorë*, 10 prill 2014.

## HYRJE

e detyruar, skllavëria, shërbëtoria, lypsaria e detyruar, trafiku i organeve, shfrytëzimi riprodhues dhe forma të tjera abuzimi e shfrytëzimi. Është e futur në ndërmarrje private, komerciale si dhe publike e qeveritare. TP është një realitet që "prek personat më të dobët të shoqërisë: gratë dhe vajzat, fëmijët, të paaftët, më të varfrit, ata që vijnë nga situata shpërbërjeje familjare e shoqërore"<sup>4</sup>. TP është një cenim i tmerrshëm i dinjitetit dhe i të drejtave njerëzore të burrave e grave, djemve e vajzave.

**4** TP është një problem shumë kompleks për shkak të larmisë së formave të saj, të heterogjenitetit të viktimave të saj dhe të larmisë së tipologjive të zbatuesve të saj. Ata që dëshirojnë të projektojnë shërbime efikase ndeshin menjëherë në sfida të mëdha. Ky kompleksitet kërkon një qasje multidisiplinore me qëllim që të kuptohen dukuria dhe shkaqet e saj, të identifikohen proceset dhe personat e përfshirë – viktimat, zbatues dhe konsumatorë (të vetëdijshëm apo jo) –, para se të kalohet në formulimin e përgjigjeve të duhura.

**5** Në të vërtetë, nga një këndvështrim antropologjik i krishterë, shenjtëria e jetës njerëzore, që nga ngjizja e saj deri në vdekjen e natyrshme, dhe dinjiteti i pacenueshëm i çdo qenieje njerëzore, përbëjnë pikënisjen dhe boshtin qendror të çdo nisme. "Bibla na mëson se çdo qenie njerëzore është krijuar për dashuri, është bërë në shëmbëlltëri e përngjasim të Hyjit (krh. Zan 1,26). Ky pohim na tregon dinjitetin tejet të madh të çdo personi njerëzor, që nuk është vetëm diçka, por është dikush. Është i aftë të njihet, të jetë zot i vetvetes, të dhurohet lirish dhe të hyjë në bashkim me persona të tjerë"<sup>5</sup>. Siç ka thënë Gjon Pali II në vitin 1988: "Kur nuk njihet dhe duhet në dinjitetin e saj si shëmbëlltëri e gjallë e Hyjit (krh. Zan 1,26), qenia njerëzore rrezikohet prej formave më poshtëruese e absurde të 'instrumentalizimit', që e bëjnë skllave të mjerë të më të fortit"<sup>6</sup>.

**6** Orientimet Baritore kanë rrënjë të thella në reflektimin dhe në mësimin e Kishës si dhe në përvojën e saj të gjerë praktike në përgjigjen ndaj nevojave të burrave, grave, djemve e vajzave viktimat të trafikimit të qenieve njerëzore dhe të skllavërisë, qoftë të kaluara qoftë të tashme. Në Koncilin II të Vatikanit, Kisha Katolike ka ripohuar shqetësimin e vet historik për punën e detyruar, duke thënë se "skllavëria, prostitucioni,

---

**4** Françesku, *Fjalim drejtuar një grupi ambasadorësh të rinj me rastin e paraqitjes së Letrave Kredenciale*, 12 dhjetor 2013.

**5** Françesku, *Ti qofsh lëvdur*, 24 maj 2015, 65; *Katekizmi i Kishës Katolike*, 357.

**6** Gjon Pali II, *Nxitja apostolike pas-sinodale Christifideles Laici*, 30 dhjetor 1988, 5.

tregtia e grave dhe të rejave, apo edhe kushtet poshtëruese të punës, me të cilat punëtorët trajtohen si mjete të thjeshta fitimi, dhe jo si persona të lirë e të përgjegjshëm (...) janë me të vërtetë të turpshme" (*Gaudium et Spes*, 27). Tani, "Kisha Katolike synon të ndërhyjë në çdo fazë të trafikimit të qenieve njerëzore", thotë Papa Françesku; ajo "dëshiron t'i mbrojë prej mashtrimit dhe prej joshjes; dëshiron t'i gjejë dhe t'i lirojë kur transportohen e skllavërohen; dëshiron t'i ndihmojë pasi të lirohen"<sup>7</sup>.

**7** Mësimet e vendosura të Papës Françesku mbi TP japin themelin për këto *Orientime Baritore*, që mbështeten edhe në përvojën e gjerë praktike të shumë OJQ-ve katolike ndërkombëtare të cilat punojnë në këtë fushë dhe në vërejtjet e shumta të përfaqësuesve të Konferencave Ipeshkvore. Edhe pse janë të miratuara nga Ati i Shenjtë, *Orientimet* nuk pretendojnë të thonë gjithçka nga mësimet e Kishës në lidhje me trafikimin e personave; por ato paraqesin një seri konsideratash thelbësore që mund të jenë të dobishme për operatorët katolikë dhe të tjerë në shërbesën e tyre baritore, në projektimin dhe në angazhimin konkret, në *advocacy* dhe në dialog.

**8** Pasi shqyrtohet përkufizimi juridik i trafikimit të personave të paraqitur nga ligji ndërkombëtar, secili prej dhjetë seksioneve të *Orientimeve* analizon realitetin e pastër dhe vështirësitë përkatëse të aspekteve të ndryshme të kësaj dukurie. Pastaj sugjerohet një seri përgjigjesh, disa prej të cilave, në veçanti, favorizojnë kulturën e takimit, që Papa Françesku e nxit si hap të nevojshëm drejt një jete të re në të gjitha fushat e padrejtësisë njerëzore dhe të vuajtjes.

---

<sup>7</sup> *Fjalë drejtuar pjesëmarrësve në Ditën IV Botërore të Lutjes dhe Reflektimit kundër Tregtisë së Personave*, 12 shkurt 2018.

# PËRKUFIZIM

---

**9** *Protokolli plotësues i Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër kriminalitetit të organizuar transkombëtar për të parandaluar, shtypur dhe ndëshkuar trafikimin e personave, në veçanti të grave e fëmijëve*<sup>8</sup> (*Protokolli i Palermos*) jep përkufizimin juridik që vijon të TP të miratuar në nivel ndërkombëtar. Neni 3, paragrafi (a) e përkufizon TP-në si "rekrutimi, transporti, transferimi, akomodimi dhe pranimi i personave, nëpërmjet përdorimit apo kërcënimit për përdorim të forcës apo të formave të tjera të detyrimit, të grabitjes, mashtrimit, gënjeshtërisë, abuzimit të pushtetit apo një pozicioni dobësie apo nëpërmjet dhënies apo marrjes së shumave të parave apo dobive për të arritur pranimin e një personi që ka autoritet mbi një tjetër me qëllim shfrytëzimin. Shfrytëzimi përfshin, si minimum, shfrytëzimin e prostituimit të tjetrit ose forma të tjera të shfrytëzimit seksual, punën e detyruar apo shërbimet e detyruara, skllavërinë apo praktika të ngjashme, nënshtrimin apo marrjen e organeve"<sup>9</sup>.

**10** *Protokolli i Palermos* e përkufizon trafikimin e fëmijëve (pra të personave nën 18 vjeç) në mënyrë paksa të ndryshme. Në këto raste, nuk është e nevojshme të tregohet se është përdorur forcë, mashtrim apo çfarëdo forme tjetër e detyrimit apo abuzimit me pushtetin apo dobësinë. Mjafton të tregohet se ka pasur një veprim rekrutimi, transporti, transferimi, akomodimi apo pranimi të një fëmije me qëllim shfrytëzimin<sup>10</sup>.

**11** Elementet e këtyre përkufizimeve të bëra me miratimin ndërkombëtar japin parametrat brenda të cilëve krimi i TP mund të ndiqet ligjërisht. Pra, pasi theksohet se *Protokolli i Palermos* integron *Konventën kundër kriminalitetit të organizuar transkombëtar*, është e rëndësishme të vëmë në dukje se ai është i zbatueshëm vetëm për shkeljet me natyrë transkombëtare dhe që implikojnë kriminalitetin e organizuar. Sidoqoftë,

---

**8** Më 12 dhjetor 2018, Protokolli plotësues i Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër kriminalitetit të organizuar transkombëtar për të parandaluar, shtypur e ndëshkuar tregtinë e personave, në veçanti të grave e fëmijëve (<http://www.ohchr.org/en/professionalinterest/pages/protocoltraffickinginpersons.aspx>) është ratifikuar nga 173 shtete anëtare. Selia e Shenjtë nuk ka aderuar ende në këtë mjet.

**9** Shih Neni 3 (a).

**10** Shih Neni 3 (c).

përkufizimi jep një pikënisje të dobishme për reflektime dhe veprime të mëtejshme kundër kësaj katastrofe.

**12** Në kohët e vona, shprehja "skllavëri moderne" shpesh është përdorur si sinonim i TP. Edhe pse shpesh personat viktimë të tregtisë përfundojnë në skllavëri, TP është më tinëzare dhe realizohet në një skenar më të gjerë se shembulli i skajshëm i sllavërisë (krh. §9). Gjithashtu, t'i shtojmë mbiemrin "moderne" termit "skllavëri" mund të jetë mashtruese, sepse mund të sugjerojë se dukuria e sotme është e ndryshme prej asaj që ndodhte në të kaluarën. Skllavëria është çnjerëzuese dhe e neveritshme në çfarëdo epoke dhe në çfarëdo forme, edhe pse gjatë historisë në dukje ajo është pranuar si një fakt i jetës.

**13** Meqenëse krimet thjesht kombëtare janë ekskluzivisht nën juridiksionin kombëtar të çdo shteti, *Konventa e Palermos* përqendrohet në ato raste trafikimi të personave që implikojnë lëvizje përtej kufijve kombëtarë dhe në veprime të kriminalitetit të organizuar. Por veprimtari me natyrë po aq të neveritshme dhe me të njëjtat rrjedhoja të tmerrshme për viktimat, mund të ndodhin edhe brenda një vendi dhe mund të kryhen nga individë (sikurse një i afërm, një i njohur, një i ashtuquajtur mik), që nuk janë të përfshirë në kriminalitetin e organizuar. Përgjithësisht, këto *Orientime Baritore* pranojnë përkufizimet e propozuara nga *Protokolli i Palermos*, por përfshijnë edhe bindjen bazë se TP është qoftë një krim qoftë një mëkat i rëndë, sepse përbën detyrim apo abuzim që çon në shfrytëzim dhe dëmton dinjitetin e personit.

**14** TP dhe kontrabandimi i migrantëve janë dukuri të dalluara nga njëra-tjetra. Kontrabandimi i migrantëve përkufizohet si "sigurimi, me qëllim që, drejtpërdrejt apo tërthorazi, të arrihet një dobi financiare apo materiale, i hyrjes së paligjshme të një personi në një Shtet Palë ku personi nuk është shtetas apo banues i përhershëm"<sup>11</sup>.

**15** Megjithëse duke e konsideruar përkufizimin e Protokollit të Palermos një pikënisje, shumë organizata të angazhuara kundër TP shtojnë ose theksojnë edhe elemente të tjera kyçe për vlerën e tyre komunikuese apo pedagogjike, duke i bërë kështu domethënien, ndikimin dhe rrjedhojat e TP më të qarta për shumë persona<sup>12</sup>. Kuptimi i TP është në ndryshim të vazhdueshëm.

<sup>11</sup> OKB, *Protokolli kundër trafikut të migrantëve nëpërmjet tokës*, detit dhe ajrit, 2000, Neni 3.

<sup>12</sup> Ndër të tjera: [www.caritas.org](http://www.caritas.org); [www.coatnet.org](http://www.coatnet.org); [www.osce.org/secretariat/trafficking](http://www.osce.org/secretariat/trafficking).

## REALITETE DHE PËRGJIGJE

---

**16** Në vijim paraqiten dhjetë grupe vërejtjesh mbi TP Bashkëkohore. Ato nisin nga analiza e realitetit të njëmendtë të TP dhe e sfidave përkatëse, për të sugjeruar pastaj përgjigje që mund të zbatohen nga persona dhe nga organizata vullnetmirë. Burimet janë mendimi dhe praktikat aktuale të Kishës Katolike për zhdukjen e TP, të shprehura nga deklarata të shumta të Papës Françesku mbi këtë argument. Këto vërejtje janë ndarë në katër seksione. Në pikën A identifikohet arsyeja e TP dhe arsyeja e vazhdimësisë së mbrapshtisë së skllavërisë në shekullin XXI. Pika B shpjegon pse TP mbetet kështu në hije. Në pikën C sqarohet se si vepron TP. Së fundi, pika D tregon se çfarë mund të bëhet dhe si mund të bëhet më mirë.

***Një prej këtyre plagëve më të dhimbshme të hapura është trafikimi i qenieve njerëzore, një formë moderne e skllavërisë, që cenon dinjitetin, dhuratë e Hyjit, në shumë vëllezër e motra tonat.***

*Françesku. Fjalim drejtuar pjesëmarrësve në Takimin mbi Trafikimin e Qenieve Njerëzore të promovuar nga "RENATE", 7 nëntor 2016*

## SHKAQET E TRAFIKIMIT

### 1. KTHIMI NË MALL DHE SHFRYTËZIMI

**17** TP merr kontrollin e viktimave të saj dhe i çon në vende e situata ku trajtohen si mall për t'u blerë, për t'u shitur e për t'u shfrytëzuar si punëtorë ose edhe si "material i papërpunuar", në mënyra të shumta e të papërfytyrueshme.

***Në shumë anë të botës, duket se nuk njih pushim cenimi i rëndë i të drejtave themelore njerëzore, sidomos i së drejtës për jetë dhe asaj për liri besimi. Dukuria tragjike e trafikimit të qenieve njerëzore (...) paraqet një shembull shqetësues të tij.***

Franchesku, Mesazh për kremtimin e Ditës XLVII të Paqes 2014, 8 dhjetor 2013

Deri në kohët e vona, ky trajtim bashkohej me kolonializmin dhe me tregtinë e skllëverve. Pavarësisht prej shfuqizimit të kësaj të fundit, shfrytëzimi i disa qenieve njerëzore nga të ngjashmit e tyre nuk ka reshtur, por ka marrë forma të reja të tmerrshme në shkallë të gjerë. Janë shfaqje të sistemeve dhe praktikave shoqërore, kulturore dhe ekonomike imorale, që nxisin qëndrime konsumiste dhe shtojnë pabarazitë mes krahinave dhe brenda vetë krahinave. Paralelisht, kohët tona kanë shënuar një rritje të individualizmit dhe të egocentrizmit, qëndrime që priren t'i konsiderojnë të tjerët në një perspektivë thjesht dobie, duke u dhënë atyre një vlerë sipas kriterëve të leverdisë dhe dobisë personale.

***Narcizizmi i bën personat të paaftë të shikojnë përtej vetvetes, përtej dëshirave dhe nevojave të tyre.***

Franchesku, Nxitja apostolike pas-sinodale *Amoris Laetitia*, 19 mars 2016

Shfrytëzimi i të tjerëve, me mbrapshti por heshturazi, është pranuar si një mjet për të arritur kënaqësi e fitim personal, edhe pse gjuha e përdorur u referohet ligjeve të tregut: gara e çregullt për të ulur – me çfarëdo mjeti –

kostot e çdo të mire apo shërbimi. TP i privon shumë individë nga identiteti dhe dinjiteti i tyre, dhe i kthen në mall për dobinë e pak vetëve.

***Çdo vit mijëra burra, gra e fëmijë janë viktima të pafajshme të shfrytëzimit për punë e seksual dhe të trafikut të organeve, dhe duket se tashmë jemi mësuar aq shumë me të, sa ta konsiderojmë si një gjë normale. Kjo është e keqe, është mizore, është kriminale! Dëshiroj të kujtoj angazhimin e të gjithëve në mënyrë që kjo plagë aberrante, formë e skllavërisë moderne, të kundërshtohet në mënyrën e duhur.***

Franchesku, *Angelus*, 20 korrik 2017

Nëse familja njerëzore dëshiron ta zhdukë TP, vetë shoqëria duhet të ndryshojë. Për t'i dhënë fund TP, të gjithë duhet t'i thjeshtësojnë nevojat e tyre, të kontrollojnë zakonet e tyre dhe t'i mbajnë nën fre orekset e tyre. "Vetëpërmbytja, përkora, vetëdisiplina dhe shpirti i sakrificës duhet të informojnë jetën e përditshme me qëllim që të mos jenë të detyruar të gjithë të pësojnë pasojat negative të moskujdesit të pak vetëve", dhe kjo "kërkon që të shmanget dinamika e sundimit dhe e grumbullimit të thjeshtë të kënaqësive"<sup>13</sup>.

**18** Dukuritë ekonomike, shoqërore e kulturore prej të cilave marrin formë shoqëritë moderne duhet t'i nënshtrohen një gjykimi të thellë etik.<sup>14</sup> Është thelbësore ta mbrojmë dinjitetin e personit njerëzor, sidomos duke paraqitur mundësi reale për zhvillimin e tërësishëm njerëzor dhe duke zbatuar politika ekonomike që favorizojnë familjen. Papa Benedikti XVI pohonte se «mbi këtë argument doktrina shoqërore e Kishës ka një ndihmesë të vetën specifike për të dhënë, që bazohet në krijimin e njeriut "në shëmbëlltë të Hyjit" (Zan 1,27), një e dhënë prej së cilës rrjedh dinjiteti i pacenueshëm i personit njerëzor, si dhe vlera transhendente e normave morale natyrore. Një etikë ekonomike që do të linte pas dore këto dy shtylla,

<sup>13</sup> Gjon Pali II, *Mesazh për Ditën XXIII Botërore të Paqes 1990*, 8 dhjetor 1989, 13 dhe Franchesku, *Ti qofsh lëvdUAR*, 24 maj 2015, 222.

<sup>14</sup> Në lidhje me këtë, Akademia Papnore e Shkencave dhe Akademia Papnore e Shkencave Shoqërore janë të angazhuara në një përpjekje të hershme me aktorë shtetërorë dhe jo, përveçse edhe me institucione ndërkombëtare e kombëtare, në studimin e dukurisë dhe në organizimin e takimeve e grupeve të punës për ta luftuar këtë krim mizor.



në mënyrë të pashmangshme do të rrezikonte ta humbiste domethënien e vet dhe të bëhej pre e instrumentalizimeve; më saktë, ajo do të rrezikonte të bëhej funksionale në sistemet ekonomiko-financiare ekzistente, në vend që të ishte ndreqëse e mosfunsioneve të tyre»<sup>15</sup>. Integriteti i çdo personi njerëzor duhet të kërkohet e nxitet gjithmonë. Siç është pohuar qartë në doktrinën katolike, politikat dhe masat për të luftuar TP duhet të synojnë zhvillimin e tërësishëm njerëzor të të gjithë personave, dhe duhet të bazohen në një qasje olistike që vë në qendër personat. «Do të dëshiroja t'u kujtoja të gjithëve, sidomos qeveritarëve të angazhuar për t'u dhënë një profil të përtërirë sistemeve ekonomike e shoqërore të botës, se kapitali i parë që duhet ruajtur e vlerësuar është njeriu, personi, në integritetin e tij: në të vërtetë, njeriu është autori, qendra dhe qëllimi i të gjithë jetës ekonomiko-shoqërore»<sup>16</sup>. Asnjë ushtrim politik e ekonomik nuk mund ta pengojë qendërsinë e personit njerëzor, dinjiteti dhe të drejtat themelore të të cilit duhet të jenë objektivi i fundit i të gjitha politikave dhe i të gjitha ekonomive.

***Liria ekonomike të mos sundojë mbi lirinë konkrete të njeriut dhe mbi të drejtat e tij, që tregu të mos jetë një absolut, por të respektojë kërkesat e drejtësisë.***

Franchesku, *Fjalim drejtuar sipërmarrësve të mbledhur në Confindustria*, 27 shkurt 2016.

**19** Në të gjithë botën, Kisha është e angazhuar të padisë kthimin në mall dhe shfrytëzimin e personave, që janë një rrjedhojë e "kulturës së skartimit" që Ati i Shenjtë e dënon në mënyrë të përsëritur dhe e lidh me "zoti parà".

***Kjo ndodh kur në qendër të një sistemi ekonomik gjendet zoti parà dhe jo njeriu, personi njerëzor. Po, në qendër të çdo sistemi shoqëror apo ekonomik duhet të jetë personi, shëmbëlltë e Hyjit, i krijuar që të ishte sundues i gjithësisë. Kur personi zhvendoset dhe arrin hyjnia para prodhohet kjo përmbysje vlerash.***

Franchesku, *Fjalim drejtuar pjesëmarrësve në Takimin Botëror të Lëvizjeve Popullore*, 28 tetor 2014

<sup>15</sup> Benedikti XVI, *Caritas in Veritate*, 29 qershor 2009, 45.

<sup>16</sup> Benedikti XVI, *Caritas in Veritate*, 29 qershor 2009, 25.

Bashkësitë katolike duhet ta padisin këtë zot të rremë; dhe edhe më shumë duhet të jenë "tharmi" i shoqërive për të nxitur ndryshime domethënëse në nivel lokal, drejt zhvillimit njerëzor të tërësishëm të të gjithëve. Edhe të gjithë të interesuarit e tjerë mund ta bëjnë këtë duke punuar për një ekonomi bashkimi.

***Mund t'i bashkëndani më shumë përfitimet për të luftuar idhujtarinë, t'i ndryshoni strukturat për të parandaluar krijimin e viktimeve dhe të skartimeve; ta dhuroni më shumë tharmin tuaj për të zënë bukën e shumë vetëve. "Jo"-ja drejtuar një ekonomie që vret le të bëhet një "po" drejtuar një ekonomie që të bën të jetosh, sepse bashkëndan, përfshin të varfrit, përdor përfitimet për të krijuar bashkim.***

*Françesku, Fjalim drejtuar pjesëmarrësve në takimim "Ekonomia e Bashkimit" i nxitur nga Lëvizja e Fokolarinëve, 4 shkurt 2017*

## 2. KËRKESA

**20** Në debatin publik është zakon t'u kushtohet shumë vëmendje trafikantëve, të cilët përbëjnë pjesën e "ofertës" të TP, edhe pse pak prej tyre arrestohen dhe shumë më pak dënohen. Flitet pak për "konsumatorët", të cilët përbëjnë pjesën e "kërkesës", që trafikantët synojnë të kënaqin. Duke konsideruar zonat e ndryshme në të cilat punojnë apo veprojnë viktimat e TP (bujqësia, puna shtëpiake, prostitucioni, etj.), konsumatorët përbëjnë një masë tejet të madhe, që duket se në pjesën më të madhe mbetet e pavetëdijshme për shfrytëzimin e viktimave të trafikimit, megjithëse gëzon dobitë dhe shërbimet që këto ofrojnë. Nëse burra, gra e fëmijë bëhen viktima të trafikimit, kjo ndodh kryesisht sepse ka një kërkesë të fortë, që e bën fitimprurës shfrytëzimin.

***Nëse ka shumë vajza viktima të trafikimit që përfundojnë në rrugët e qyteteve tona, kjo ndodh sepse shumë burra këtu – të rinj, në moshë të mesme, të moshuar – kërkojnë këto shërbime dhe janë të gatshëm të paguajnë për kënaqësinë e tyre. Atëherë, pyes veten, a janë me të vërtetë trafikantët shkaku kryesor i trafikimit? Unë besoj se shkaku kryesor është egoizmi i paskrupullt i shumë personave hipokritë të botës sonë. Sigurisht, të arrestohen trafikantët është një detyrë drejtësie. Por zgjidhja e vërtetë është kthimi i zemrave, ndërprerja e kërkesës për ta shterur tregun.***

*Franchesku, Fjalë drejtuar pjesëmarrësve në Ditën IV Botërore të Lutjes dhe Reflektimit kundër Trafikimit të Personave, 12 shkurt 2018*

Ai që krijon kërkesën bashkëndan personalisht përgjegjësinë e impaktit shkatërrimtar të sjelljes së tij mbi genie të tjera njerëzore dhe të vlerave morale të cenuara në këtë proces.

**21** Për ta pakësuar kërkesën që gjendet në origjinën e TP është e nevojshme që vërtetimi i përgjegjësive, përndjekja e saj dhe dënimi i krejt zinxhirit të shfrytëzimit, të sigurohen, që nga rekrutuesit deri te konsumatorët.

***Nuk mund të shtiremi sikur jemi të shpërqendruar: jemi të gjithë të thirrur të dalim nga çfarëdo forme hipokrizie, duke përballur realitetin se jemi një pjesë e problemit. Problemi nuk është në trotuarin përballë: më përfshin. Nuk na lejohet të shohim nga ana tjetër dhe të deklarojmë padijen apo pafajësinë tonë.***

*Françesku, Videomesazh drejtuar pjesëmarrësve në Forumin Ndërkombëtar mbi Skllavërinë Moderne, 7 maj 2018*

Të dënohet ai që është shfrytëzuar dhe zënë në kurth nuk duket se është një zgjidhje efikase, meqenëse arrihet të fajësohen e të ndëshkohen viktimat. Përkundrazi, duhet të nxirret në pah tregu i madh që gjendet pas këtyre shërbimeve. Blerja e "shërbimeve seksuale", në të gjitha format e tyre – përfshirë pornografinë, cyber-sex në internet, striptease dhe vallen erotike – është një cenim serioz i dinjitetit njerëzor dhe i integritetit njerëzor, si dhe është një fyerje ndaj seksualitetit njerëzor. Shtetet duhet të konsiderojnë mundësinë që të kriminalizojnë atë që përfiton nga prostitucioni apo nga forma të tjera të shfrytëzimit seksual të siguruar nga viktimat e tregtisë. Është e nevojshme që të përcaktohen përgjegjësitë gjatë gjithë zinxhirit të shfrytëzimit edhe kur TP përdoret për martesë të detyruara, shërbëtori, lypje të detyruara, trafik organesh dhe shfrytëzim riprodhues. Duhet të nxiten fushata sensibilizimi në lidhje me përgjegjësitë ligjore të atyre që krijojnë kërkesën e TP, si në nivel kombëtar ashtu edhe në nivel ndërkombëtar, me bashkëpunimin e të gjitha palëve të interesuara.

***Bota ka nevojë për shenja konkrete solidariteti, sidomos para tundimit të indiferencës.***

*Françesku, Fjalim drejtuar pjesëmarrësve në Jubileun e Vepruesve të Mëshirës, 3 shtator 2016*

**22** Blerja e shërbimeve seksuale të një prostitute nuk ka aspak lidhje me dashurinë; në të vërtetë, ky akt përfaqëson një fyerje serioze ndaj dinjitetit njerëzor.

***(Prostitucioni) është torturë ndaj një femre. Të mos i ngatërrojmë termat. Kjo është kriminale. Mendësi e sëmurë. Dhe unë dua (...) t'ju kërkoj falje ju dhe shoqërisë, për të gjithë katolikët që bëjnë këtë akt kriminal.***

Franchesku, *Takim parasinodal me të rinjtë*, 19 mars 2018

Sikurse Papa Françesku ka pasur mundësinë t'i thotë një gruaje të re nigeriane të mbijetuar të TP, kthimi është i nevojshëm edhe në bashkësitë e krishtera, të cilat janë të thirrura t'i japin mbështetje çdo nisme që synon ta zhdukë "kërkesën" që krijon zinxhirin e shfrytëzimit të TP. «Pyes veten se si dikush, që gjendet ballë për ballë me persona që vuajnë realisht prej dhunës dhe shfrytëzimit seksual, mund të shpjegojë se këto tragjedi, të riprodhuara në formë virtuale, duhet të konsiderohen thjesht si "zbavitje"»<sup>17</sup>. Kjo pyetje e Papës Benedikti XVI përbën një thirrje drejtuar të gjithë katolikëve që të angazhohen për të sensibilizuar konsumatorët në lidhje me përgjegjësitë e tyre morale e civile.

<sup>17</sup> Benedikti XVI, *Fjalim në Festën e mirëprirjes së të rinjve në Barangaroo*, 17 korrik 2008.

## NJOHJA E TRAFIKIMIT

### 3. NGURRIMI PËR TË NJOHUR TRAFIKIMIN

**23** Pavarësisht prej angazhimeve të marrura publikisht nga Shtetet dhe organizatat e shoqërisë civile dhe pavarësisht prej realizimit të shumë fushatave të sensibilizimit, ka ende një padituri të madhe në lidhje me natyrën dhe shtrirjen e TP.

***Sigurisht që në lidhje me temën e trafikimit ka shumë padituri. Por nganjëherë duket se ka edhe pak vullnet për të kuptuar rëndësinë e problemit. Pse? Sepse i prek nga afër ndërgjegjet tona, sepse është i vështirë, sepse na bën të turpërohem. Pastaj, ka prej atyre që, megjithëse duke e njohur, nuk do që të flasë për të sepse gjendet në fund të “zinxhirit të konsumit”, si përdorues i “shërbimeve” që ofrohen në rrugë ose në internet.***

*Françesku, Fjalë drejtuar pjesëmarrësve në Ditën IV Botërore të Lutjes dhe Reflektimit kundër Tregtisë së Personave, 12 shkurt 2018*

Personat viktime të trafikimit përgjithësisht mbeten të padukshëm; TP nuk perceptohet apo identifikohet lehtë në shoqërinë përreth. Shumë persona janë të gatshëm ta dënojnë TP në vende të tjera, por nuk arrijnë të shohin se ajo është e pranishme në lagjen e tyre dhe në realitetin e tyre virtual.

***Një vëmendje e veçantë u duhet kushtuar migrantëve fëmijë, familjeve të tyre, atyre që janë viktime të rrjeteve të trafikut të qenieve njerëzore dhe atyre që janë të shpërngulur për shkak të konflikteve, fatkeqësive natyrore dhe përndjekjeve. Të gjithë ata shpresojnë që të kemi guximin ta shembim murin e atij bashkëpunimi të rehatshëm e të heshtur që e rëndon situatën e tyre të braktisjes dhe që ta drejtojmë nga ata vëmendjen tonë, dhembshurinë tonë dhe përkushtimin tonë.***

*Françesku, Mesazhi me rastin e bashkëbisedimit Seli e Shenjtë – Meksikë mbi migrimin ndërkombëtar, 14 qershor 2014*

Mjerisht, viktimat e trafikimit shpesh manipulohen dhe zihen në kurth në skema psikologjike që nuk u lejojnë të ikin, të kërkojnë ndihmë apo madje edhe të kenë një kuptim të qartë të gjendjes së tyre – të kaluar por edhe të tashme – si viktima të veprimtarive kriminale.

***Nuk duhet t'i nënvleftësojmë rreziqet që gjenden në disa prej këtyre hapësirave virtuale; nëpërmjet rrjetit shumë të rinj zihen dhe tërhiqen në një skllavëri prej së cilës pastaj është e pamundur të lirohen me aftësitë e veta.***

*Françesku, Fjalë drejtuar pjesëmarrësve në Ditën IV Botërore të Lutjes dhe Reflektimit kundër Tregtisë së Personave, 12 shkurt 2018*

Gjithashtu, shumë prej atyre të cilët duhet të gjenden në linjë të parë – oficerë policie, prokurorë, autoritete gjyqësore, veprues shëndetësorë e shoqërorë – shpesh nuk i kanë fituar nocionet e nevojshme për të individualizuar dhe trajtuar viktimat e TP me kompetencën, maturinë dhe ndjeshmërinë e nevojshme.

**24** Kur TP realizohet përtej kufijve të një vendi, bashkësitë e prejardhjes, tranzitit dhe destinacionit duhet të informohen në mënyrën e duhur. Mes informacioneve të rëndësishme duhen përfshirë ato në lidhje me parandalimin, me identifikimin dhe me ndjekjen e TP; ato që kanë lidhje me rreziqet, mënyrat dhe pasojat e TP, dhe ato që kanë lidhje me ligjet ndërkombëtare e kombëtare që zbatohen për të. Duhet që, në nivel lokal, të paraqiten programe edukative dhe vetedukative specifike me qëllim që të shtohet aftësia e parandalimit, mbrojtjes, ndjekjes dhe bashkëpunimit.

***Në vitet e fundit, Selia e Shenjtë (...) i ka shtuar thirrjet drejtuar bashkësisë ndërkombëtare me qëllim që aktorët e ndryshëm t'i bashkojnë përpjekjet dhe të bashkëpunojnë për t'i dhënë fund kësaj plage. Gjithashtu, janë organizuar disa takime me qëllim që t'i jepet dukshmëri dukurisë së tregtisë së personave (...) Uroj që ky angazhim të vazhdojë dhe të forcohet në vitet e ardhshme.***

*Françesku, Mesazh për Ditën XLVIII Botërore të Paqes 2015, dhjetor 2014*

Këto programe duhet të përmbajnë edhe një përfshirje të viktimave të trafikimit.

***Të gjithë ata që kanë qenë viktimë të trafikimit janë burim i pashtershëm mbështetjeje për viktimat e reja dhe burime tejet të rëndësishme informative për të shpëtuar shumë të rinj të tjerë.***

*Françesku, Fjalë drejtuar pjesëmarrësve në Ditën IV Botërore të Lutjes dhe Reflektimit kundër Trafikimit të Personave, 12 shkurt 2018*

Gjithashtu, të rinjtë duhet të edukohen që të jetojnë një seksualitet të përgjegjshëm, në kontekstin e një martese të jetuar në besnikëri dhe për gjithë jetën, që të tregojnë respekt etik për të tjerët, që ta përdorin internetin me maturi e shoshitje dhe të informohen në lidhje me origjinën e me fabrikimin e produkteve që blejnë.

***Nismat që synojnë luftën kundër trafikimit të personave, në objektivin e tyre konkret që t'i shpërbëjnë rrjetet kriminale, duhet t'i konsiderojnë gjithnjë e më shumë sektorët më të gjerë të lidhur me të, si për shembull përdorimin e përgjegjshëm të teknologjive dhe të mjeteve të komunikimit, për të mos folur për studimin e implikimeve etike të modeleve të rritjes ekonomike që privilegjojnë përfitimin mbi personat.***

*Françesku, Fjalim drejtuar anëtarëve të "Santa Marta Group", 9 shkurt 2018*

**25** Katolikët duhet të përfshihen personalisht, si brenda familjes së tyre ashtu edhe në nivel bashkësie, në nisma që synojnë të sensibilizojnë dhe të edukojnë të rinjtë, në mënyrë që TP të parandalohet dhe të luftohet në mënyrë efektive.

***Puna e sensibilizimit duhet të fillojë nga shtëpia, nga ne vetë, sepse vetëm kështu do të jemi të aftë pastaj të ndërgjegjësojmë bashkësitë tona, duke i nxitur të***



**angazhohen që asnjë qenie njerëzore të mos jetë më viktimë e trafikimit.**

Franchesku, Fjalë drejtuar pjesëmarrësve në Ditën IV Botërore të Lutjes dhe Reflektimit kundër Trafikimit të Personave, 12 shkurt 2018

**Një angazhim i parë (...) është vënia në veprim e një strategjie që lejon një njohje të rëndësishme të temës, duke e zhdukur atë vetë indiference që duket se rëndon mbi fatin e kësaj pjese të njerëzimit që vuan, që është duke vuajtur.**

Franchesku, Videomesazh drejtuar pjesëmarrësve në Forumin Ndërkombëtar mbi Skllavërinë Moderne, 7 maj 2018

#### 4. IDENTIFIKIMI DHE REFERIMI I TRAFIKIMIT

**26** Identifikimi dhe paditja e krimeve të lidhura me TP pengohen nga faktorë të ndryshëm. Hetimet e policisë janë të gjata dhe të vështira. Mbledhja e provave në lidhje me këtë veprimtari kriminale pengohet edhe nga korrupsioni që përhapet me shpejtësi dhe nga mungesa e bashkëpunimit nga ana e autoriteteve të vendeve të tjera.

***Edhe korrupsioni i atyre që janë të gatshëm të bëjnë gjithçka për t'u pasuruar duhet radhitur mes shkaqeve të skllavërisë. Në të vërtetë, skllavërimi dhe trafikimi i personave kërkojnë një bashkëpunim që shpesh kalon nëpër korrupsionin e ndërmjetësve, të disa anëtarëve të forcave të rendit apo të aktorëve të tjerë shtetërorë apo institucioneve të ndryshme, civile e ushtarake.***

Françesku, Mesazh për kremtimin e Ditës XLVIII Botërore të Paqes 2015, 8 dhjetor 2014

Forcat e rendit dhe autoritetit gjyqësor nuk janë të pajisura me burime të përshtatshme për të luftuar TP; kësaj shpesh i shtohen mungesa e juridiksioneve të qarta dhe e hierarkive të përcaktuara. Duhet që forcat e rendit, përveç qasjes tradicionale, të marrin në konsideratë edhe zgjedhje të tjera, sikurse, për shembull, realizimi i hetimeve financiare. Natyra komplekse dhe shumë-sektoriale e TP përfaqëson një vështirësi të mëtejshme. Pastaj ka elemente kulturore që e pengojnë njohjen e menjëhershme të TP. Të mbijetuarit shpesh nuk e padisin kriminelin për arsye të ndryshme. Është frika, krejt e ligjshme, ajo që shpesh i bën të mos duan t'i padisin kriminelët dhe të dëshmojnë kundër tyre. Duke u ballafaquar me kërcënime reale, druajnë për jetën e tyre dhe për atë të familjarëve të tyre, ose kanë frikë se do të ndëshkohen për faktin se nuk i kanë të gjitha dokumentet në rregull. Shpesh ndiejnë turp, ndihen krejtësisht vetëm dhe nuk janë në gjendje t'i zënë besë askujt. Trauma që kanë përjetuar mund t'i bëjë të ngurrojnë ose të mos jenë të aftë t'i tregojnë historitë e tyre, të mos duan t'i kujtojnë abuzimet mizore dhe vuajtjet. Kërcënimet, dhuna dhe dëshpërimi i paralizojnë në të njëjtën mënyrë në të cilën më parë futeshin në kurth prej trafikantëve të tyre.

***Ekziston një e dhënë sociologjike: kriminaliteti i organizuar dhe trafikimi i paligjshëm i qenieve njerëzore i zgjedhin viktimat e tyre mes personave që sot kanë mjete të pakta jetese dhe edhe më pak shpresa për të ardhmen. Për të qenë më i qartë: mes më të varfërve, mes më të mënjanuarve, mes më të skuartuarve.***

Franchesku, Videomesazh drejtuar pjesëmarrësve në Forumin Ndërkombëtar mbi Skllavërinë Moderne, 7 maj 2018

**27** Për të favorizuar shqyrtimin e TP dhe paditjen e saj, forcat e rendit, prokuroria, autoritetet gjyqësore dhe profesionistët socio-shëndetësorë duhet të jenë të formuar dhe të informuar siç duhet për identifikimin e TP dhe për të nisur një proces penal në përputhje me ligjet ndërkombëtare e kombëtare të zbatueshme. Korrupsioni dhe mbyllja e syve në nivel qeveritar duhet të paditen dhe ndiqen me forcë. Duhet të nxitet një *advocacy* e përshtatshme nga ana e të gjithë të interesuarve, përfshirë edhe të mbijetuarit e TP, në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, me qëllim që të realizohen udhëzimet e të gjitha Traktateve ndërkombëtare, rregullat dhe standartet që respektojnë të drejtat e migrantëve dhe nxisin zhvillimin e tërësishëm të personit njerëzor, koherentë me Doktrinën e Kishës. Të mbijetuarit e TP duhet të nxiten – por jo të detyrohen – që të marrin pjesë në proceset penale kundër shfrytëzuesve të tyre. Ata që dëshirojnë të bashkëpunojnë duhet të kenë një mbështetje të përshtatshme për ta bërë këtë në mënyrë të sigurt. Çfarëdo elementi që mund t'u shkaktojë stres të mëtejshëm ose frikë duhet të shmanget. Paprekshmëria e tyre duhet të garantohet, ashtu si edhe mbrojtja e privatësisë, një vendbanim i sigurt dhe një asistencë e përshtatshme sociale e psikologjike. Viktimave të mitura të tregtisë duhet t'i sigurohet një mbrojtje e veçantë; çfarëdo projekti në lidhje me të ardhmen e tyre duhet të bazohet në interesin më të madh të të miturit, duke marrë në konsideratë të drejtat dhe detyrat e prindërve të tyre, të tutorëve të tyre apo të personave të tjerë që kanë përgjegjësi ligjore mbi ta<sup>18</sup>.

***“Mbrojtja” kujton detyrën për të njohur dhe tuteluar dinjitetin e pacenueshëm të atyre që ikin nga një rrezik real në kërkim të strehimit dhe sigurisë, për të ndaluar shfrytëzimin e tyre. Mendoj veçanërisht për gratë dhe për fëmijët që gjenden në situata në të cilat kanosen nga***

<sup>18</sup> Konventa mbi të Drejtat e Fëmijëve, Neni 3.

***rreziqe dhe nga abuzime që arrijnë deri në atë pikë sa t'i bëjnë skllëvër.***

Françesku, *Mesazh për kremtimin e Ditës LI Botërore të Paqes (1 janar 2018)*,  
24 nëntor 2017

Aty ku është e përshtatshme, duhet që avokatëve, shoqatave civile dhe organizatave konfesionale t'u lejohet që të përfaqësojnë të mbijetuarit në hetimet dhe në proceset ligjore. Detyrimi për të paraqitur provën nuk duhet të bjerë vetëm mbi të mbijetuarit e TP. Derisa krimi i TP do të vazhdojë të mbetet i fshehur, trafikantët do të vazhdojnë të veprojnë pothuajse të pandëshkuar.

**28** Angazhimi i patundur për t'i kundërshtuar dukurisë së shëmtuar të TP vazhdon ta nxisë punën e shërbimit dhe të *advocacy*-së së organizatave me frymëzim katolik. Kishat, bashkësitë e krishtera dhe organizatat e tjera fetare, që kanë fituar besimin e viktimave të tregtisë, duhet të nxiten për të bashkëpunuar me hetimet e policisë dhe me proceset. "Në të vërtetë, shumë të mbijetuar të trafikimit e kanë të vështirë t'u zënë besë forcave të rendit dhe kjo e ndërlikon shumë lirin e tyre dhe ndjekjen ligjore të trafikantëve të tyre. Përvoja na mëson se është shumë më e thjeshtë për ta t'u zënë besë rregulltareve ose personelit tjetër të Kishës, që mund ta risin besimin e tyre gjatë proceseve ligjore dhe t'u sigurojnë një port të sigurt dhe forma të tjera asistence<sup>19</sup>.

<sup>19</sup> Paul R. Gallagher, *Ndërrhyrje mbi mbrojtjen dhe asistencën e viktimave*, 28 shtator 2017.

## DINAMIKAT E TRAFIKIMIT

### 5. LIDHJA ME BOTËN E BIZNESIT

**29** Financa moderne, tregtia, transportet dhe komunikimet i ofrojnë personave të paskrupujt mundësi joshëse për të hyrë në sistemin e mashtrimit dhe të shfrytëzimit të qenieve njerëzore. Në disa sektorë si bujqësia, peshkimi, ndërtimtaria dhe veprimtaria minerare, TP është shtrirë falë bashkëpunimit mes fajtorëve të ndryshëm e të shumtë. Kjo e ka bërë dukurinë më kkomplekse dhe e ka ndërlikuar analizën e shkaqeve të saj dhe të ndikimit të saj. Krimi fshihet lehtë brenda disa modeleve moderne sipërmarrjeje. Indinjata, edhe pse tërësisht me vend, priret ta errësojë logjikën e ftohtë të TP si sistem tejet fitimprurës, që mund të inkorporohet edhe në sipërmarrje të respektueshme. Kur fillojnë nisma të lavdërueshme për të zhdukur TP, sipërmarrësit e paskrupujt thjesht ndryshojnë taktikë për të shmangur kundërmasat.

**30** Është e nevojshme të formulohet urgjentisht një gjykim etik mbi modelet komerciale të sotme me qëllim që të nxirren në pah mekanizmat e mashtrimit dhe të shfrytëzimit të përdorura nga sipërmarrjet. Kisha i nxit të dyja palët e përfshira në marrëdhëniet komerciale – sipërmarrësit që prodhojnë dhe konsumatorët përfundimtarë që blejnë – që të angazhohen në këtë reflektim etik dhe të realizojnë ndryshimet e nevojshme.

***Modelet ekonomike, pra, duhet të respektojnë një etikë zhvillimi të tërësishëm dhe të qëndrueshëm, të bazuar në vlera që vënë në qendër personin njerëzor dhe të drejtat e tij.***

Franchesku, Mesazhi drejtuar presidentit ekzekutiv të World Economic Forum, 23 janar 2018

**31** Kisha është e angazhuar të nxisë vlera dhe modele komerciale që u lejojnë individëve dhe popujve të realizojnë planin e Hyjit për njerëzimin dhe të lehtësojnë pjesëmarrjen e të gjithëve në ekonomi.

***Sipërmarrja dhe zyra drejtuese e firmave mund të bëhen vende të shenjtërit, nëpërmjet angazhimit të***

***secilit për të ndërtuar marrëdhënie vëllazërore mes sipërmarrësve, drejtuesve e punëtorëve, duke favorizuar bashkëpërgjegjësinë dhe bashkëpunimin në interesin e përbashkët.***

Françesku, *Fjalim në Bashkimin e Krishterë të Sipërmarrësve Drejtues (BKSD)*, 31 tetor 2015

Të gjithë katolikët janë të thirrur të angazhohen personalisht për ta bërë shoqërinë më të drejtë, respektuese dhe përfshirëse, duke i zhdukur të gjitha format e shfrytëzimit, sidomos ato më të pashpirt.

***Ndërsa individë e grupe spekulojnë turpshëm me skllavërinë, ne të krishterët, të gjithë së bashku, jemi të thirrur të zhvillojmë gjithnjë e më shumë një bashkëpunim më të madh, në mënyrë që të tejkalohet çdo lloj pabarazie, çdo lloj diskriminimi, që janë pikërisht ato që bëjnë të mundur që një njeri të mund të bëjë skllav një njeri tjetër. Një angazhim i përbashkët për ta përballuar këtë sfidë do të jetë një ndihmë e çmueshme për ndërtimin e një shoqërie të përtërirë dhe të orientuar drejt lirisë, drejtësisë dhe paqes.***

Françesku, *Videomesazh drejtuar pjesëmarrësve në Forumin Ndërkombëtar mbi Skllavërinë Moderne*, 7 maj 2018

## 6. KUSHTET E PUNËS DHE RRJETI I FURNIZIMIT

**32** TP shpesh është e fshehur në labirintin e rrjetin e furnizimit. Shtimi i vazhdueshëm i garës së tregjeve i detyron ndërmarrjet ta kufizojnë koston e punës dhe të blejnë lëndë të para me çmim sa më të ulët.

***Shumë më tepër bartin çdo ditë peshën e një sistemi ekonomik që e shfrytëzon njeriun, i vë një "zgjedhë" të padurueshme, që pakica e të privilegjuarve nuk dëshiron ta bartë.***

Franchesku, *Angelus*, 6 korrik 2014

Shpesh punëtorët nuk kanë zgjedhje tjetër veçse të firmosin kontrata që parashikojnë kushte shfrytëzimi. Rrallëherë bëhen vlerësime etike dhe të thelluara të dimensioneve njerëzore të proceseve të furnizimit, prodhimit, shpërndarjes dhe riciklimit. Vëmendja që sot po fillon t'u jepet radhëve të furnizimit është duke ndihmuar në shtimin e transparencës dhe përgjegjësisë; por kjo nuk duhet të na shpërqendrojë prej një hetimi të ndershëm e të kuptueshëm mbi përgjegjësitë reale të konsumatorëve dhe të vendeve në të cilat jetojnë.

***Shtetet duhet të kujdesen që legjislacionet e tyre kombëtare mbi migrimet, mbi punën, mbi adoptimet, mbi delokalizimin e ndërmarrjeve dhe mbi komercializimin e prodhimeve të realizuara nëpërmjet shfrytëzimit të punës ta respektojnë realisht dinjitetin e personit.***

Franchesku, *Mesazh për kremtimin e Ditës XLVIII të Paqes 2015*, 8 dhjetor 2014

**33** Çështja e kërkesës së të mirave me kosto të ulët, që kërkon punë me kosto të ulët, duhet të përballohet me gatishmëri dhe korrektësi, qoftë nëpërmjet sensibilizimit publik qoftë nëpërmjet ligjesh të reja. Për të nxitur një model ekonomik të drejtë, që nxit zhvillimin të tërësishëm njerëzor të të gjithëve, ligji duhet t'u kërkojë ndërmarrjeve, veçanërisht atyre që veprojnë në nivel transkombëtar dhe në vende në rrugë zhvillimi, që të investojnë në transparencën dhe në verifikimin e radhëve të tyre të furnizimit.

***Në të vërtetë, ndërmarrjet kanë detyrën t'u garantojnë të punësuarve të tyre kushte pune dinjitoze dhe paga të përshtatshme, por edhe të kujdesen që format e skllavërimit apo të trafikut të personave njerëzorë të mos kenë vend në zinxhirët e shpërndarjes.***

Franchesku, *Mesazh për kremtimin e Ditës XLVIII të Paqes 2015*, 8 dhjetor 2014<sup>20</sup>

Duhet të vendosen rregullore që kërkojnë kontrata të bëra ligjërisht, pa klauzola abuzive, dhe që respektohen siç duhet. Duhet të informohen konsumatorët, nëpërmjet fushatave të sensibilizimit, mbi përfshirjen e mundshme të viktimave të TP në çfarëdo faze të procesit të prodhimit. "Është mirë që personat të kuptojnë se blerja është gjithmonë një akt moral, përveçse edhe ekonomik. Pra, ka një përgjegjësi të saktë shoqërore të konsumatorit, që shoqëron përgjegjësinë shoqërore të ndërmarrjes"<sup>21</sup>.

***Para së gjithash, duhet të bëjmë që të fitohet më shumë vetëdije për këtë të keqe të re që, në botën globale, dëshirohet të fshihet sepse është skandaloze dhe "politikisht jo korrekte". Askujt nuk i pëlqen të pranojë se në qytetin e vet, edhe në lagjen e vet, në krahinën apo kombin e vet ka forma të reja skllavërie, ndërsa dimë se kjo plagë u përket gati të gjitha vendeve.***

Franchesku, *Fjalim drejtuar pjesëmarrësve në seksionin plenar të Akademisë Papnore të Shkencave Shoqërore*, 18 prill 2015

**34** Sipërmarrësit katolikë duhet të vënë në jetë mësimet e Kishës, duke siguruar kushte pune dinjitoze dhe paga që lejojnë jetesën e familjes së punëtorëve. «Të njohim dimensionin subjektiv të punës na lejon që të marrim parasysh dinjitetin dhe rëndësinë e saj. Na lejon të kuptojmë se puna është "për njeriun" dhe jo njeriu "për punën". Bashkëpunëtorët nuk janë thjesht "burime njerëzore" apo "kapital njerëzor"»<sup>22</sup>. Të gjitha zyrat kishtarë, kongregatat rregulltare dhe organizatat katolike duhet të garantojnë

<sup>20</sup> Shih edhe: *Ti qofsh lëvdUAR*, 123.

<sup>21</sup> Benedikti XVI, *Caritas in Veritate*, 66.

<sup>22</sup> Dikasteri për Shërbimin e Zhvillimit Njerëzor të Tërësishtëm, *Thirrja e Drejtuesit të Sipërmarrjes. Një Reflektim*, Romë 2018, 49.



burimet për formimin dhe kompetencat e nevojshme për monitorimin e politikave të veta në lëndën e tenderave dhe kontratave të punës, për t'u siguruar që këta respektojnë të drejtat njerëzore themelore dhe dinjitetin.

***“Të bashkuar për të mbrojtur shpresën”, kërkon kulturë më të madhe të transparencës mes enteve publike, sektorit privat dhe shoqërisë civile, dhe nuk përjashtoj organizatat kishtare. Askush nuk mund ta konsiderojë veten të huaj në këtë proces; korrupsioni është i shmangshëm dhe kërkon angazhimin e të gjithëve.***

*Franchesku, Takim me autoritetet, shoqërinë civile dhe trupin diplomatik, Oborri i nderit i pallatit të qeverisë (Lima), 19 janar 2018*

## 7. TRAFIKIMI DHE KONTRABANDIMI I MIGRANTËVE

**35** Në realitet, kufiri mes kontrabandimit të migrantëve dhe TP është duke u bërë gjithnjë e më i hollë. Një situatë e filluar si kontrabandim migrantësh mund të zhvillohet lehtë në TP. Në vitet e fundit, brenda flukseve të mëdha dhe të përziera të migrantëve e refugjatëve, shumë persona të dëshpëruar, të detyruar prej mungesës së alternativave të ligjshme, të shkaktuara edhe nga politika imigrimi gjithnjë e më kufizuese, e kanë filluar aventurën e tyre duke kontraktuar me persona që do të favorizonin migrimin e tyre, edhe të parregullt, për t'u gjendur pastaj viktimë të trafikimit. Kur programet humanitare, të zbatuara nga institucione apo nga organizata të shoqërisë civile, nuk arrijnë t'i bëjnë ballë numrit të personave që kërkojnë mbrojtje e risistemim dhe, për më tepër, asistencë humanitare ndërkombëtare dhe e zhvillimit pakësohet, ata të cilët favorizojnë migrimin e parregullt fillimisht dhe trafikantët pastaj bëhen përfitues ekspertë nga kjo pamjaftueshmëri.

***Trafikantët janë shpesh persona të paskrupujt, pa moral e pa etikë, që jetojnë mbi fatkeqësitë e të tjerëve, duke përfituar prej emocioneve njerëzore dhe prej dëshpërimit të njerëzve për t'ua nënshtruar ata vullnetit të tyre, duke i bërë skllavër dhe të nënshtruar. Mjafton të mendojmë sa gra afrikane shumë të reja arrijnë në brigjet tona duke shpresuar të fillojnë një jetë më të mirë, duke menduar se do ta sigurojnë jetesën ndershëmërisht, ndërsa pastaj bëhen skllave, të detyruara që të prostituohen.***

Franchesku, *Fjalë drejtuar pjesëmarrësve në Ditën IV Botërore të Lutjes dhe Reflektimit kundër Tregtisë së Personave*, 12 shkurt 2018

**36** Për të mos lejuar që personat të zgjedhin t'i paguajnë ata që u ofrojnë rrugë migrimi të parregullt dhe të bien eventualisht në duart e trafikantëve, në radhë të parë do të duhej të garantohej që ata të mos jenë të detyruar ta lënë tokën e tyre. Pra, forma e parandalimit më rrënjësore është të sigurohet e drejta për të qëndruar në vendin e vet të origjinës, duke u siguruar të gjithëve qasjen në të mirat e nevojës së parë dhe mundësinë për një zhvillim njerëzor të tërësishëm. Nevojat parësore të personave bëhen edhe më të forta në situata konflikti të armatosur apo dhune, që shpesh i detyrojnë të ikin edhe pa përgatitjen e mbrojtjen më të vogël. Në rast se, për arsye më të ndryshme, kanë vendosur të nisen,

ose e shohin veten të detyruar ta bëjnë këtë, sidoqoftë mund të shmangët kontrabandimi i migrantëve dhe TP nëpërmjet paraqitjes së rrugëve ligjore më të gjera, që garantojnë një migrim të sigurt dhe të rregullt.

***Të pranosh do të thotë para së gjithash t'u japësh migrantëve dhe refugjatëve mundësi më të gjera hyrjeje të sigurt e ligjore në vendet e destinacionit. Në këtë kuptim, është i dëshirueshëm një angazhim konkret në mënyrë që të shtohet e të thjeshtësohet dhënia e vizave humanitare dhe për bashkim familjar.***

Franchesku, Mesazh për Ditën Botërore të Migrantit dhe të Refugjatit 2018, 15 gusht 2017

Duhet të sigurohen dhe të përhapen informacione të besueshme në lidhje me migrimin dhe azilin.

***Cilësia etike e komunikimit, në fund të fundit, është fryt i vetëdijeve të vëmendshme, jo sipërfaqësore, që i respektojnë gjithmonë personat, qoftë ata që janë objekt i informacionit, qoftë i destinatarëve të mesazhit. Secili, në rolin e vet dhe me përgjegjësinë e vet, është i thirrur të bëjë kujdes për ta mbajtur lart nivelin etik të komunikimit.***

Franchesku, Fjalim para drejtuesve dhe personelit të RAI-Radiotelevisione Italiana, 18 janar 2014

Gjithashtu duhet intensifikuar ndjekja specifike e krimit të organizuar që i kushtohet kontrabandimit të migrantëve dhe TP në nivel kombëtar e ndërkombëtar. Në të njëjtën mënyrë duhet luftuar me çdo mjet miratimi i heshtur i autoriteteve lokale e kombëtare.

***Korrupsioni është një mashtrim ndaj demokracisë dhe u hap dyert të këqijave të tjera të tmerrshme sikurse droga, prostitucioni dhe tregtia e personave, skllavëria, trafikimi i organeve, trafiku i armëve, e kështu me radhë.***

Franchesku, Fjalim drejtuar pjesëmarrësve në Konferencën Ndërkombëtare të Shoqatave të Sjpërmarrësve Katolikë (UNIAPAC), 17 nëntor 2016

**37** Kisha është e angazhuar t'i mbrojë viktimat e TP. Në radhë të parë, ky angazhim do të thotë t'u kujtojmë prindërve e familjeve rolin e tyre si mbrojtësit e parë kundër trafikantëve. Të gjithë duhet të nxiten që të nxjerrin në pah dhe të padisin praktikat e paligjshme të rekrutimit, të angazhohen në veprimtari të mundshme për ta, dhe të punojnë për të përhapur një shpirt drejtësie e për të bërë që të zgjerohen rrugët ligjore për migrantët dhe ata që kërkojnë azil.

***Mbrojtja e këtyre vëllezërve e motrave është një kërkesë morale që duhet përkthyer (...) duke realizuar programe në kohë të duhur dhe humanizuese në luftën kundër "trafikantëve të mishit njerëzor" që përfitojnë prej fatkeqësive të të tjerëve.***

Françesku, *Fjalim drejtuar pjesëmarrësve të Forumit Ndërkombëtar "Migrimet dhe Paqja", 21 shkurt 2017*

## PËRGJIGJET NDAJ TRAFIKIMIT

### 8. FORCIMI I BASHKËVEPRIMIT

**38** Aktualizimi i *Protokollit të Palermos* është paraqitur përgjithësisht nëpërmjet modelit të 3 drejtimeve: parandalim, mbrojtje, ndjekje. Shumë institucione kombëtare dhe ndërkombëtare i kanë përdorur këto linja për të zhvilluar politika e programe. Gjithashtu, ka edhe një drejtim të katërt, ai i "*partnership*"-it, jo më pak i rëndësishëm se të tjerët, që rrezikon të mbetet në plan të dytë. Mungesa e bashkëpunimit – për të mos thënë gara – mes aktorëve të ndryshëm shtetërorë, shpesh i bën jo shumë efikase politikat dhe programet e projektuara mirë.

***Në disa raste, mungesa e bashkëpunimit mes Shteteve i lë shumë persona jashtë ligjshmërisë dhe pa mundësinë që të bëjnë të vlejshme të drejtat e tyre, duke i detyruar të vendosen mes atyre që përfitojnë nga të tjerët ose të dorëzohen për të qenë viktimë të abuzimeve.***

*Francesku, Mesazhi drejtuar presidentit të Panamasë me rastin e Takimit VII të nivelit të lartë të Amerikave, 10 prill 2015*

Kjo ndodh në nivel ndërkombëtar, kombëtar dhe lokal. Vështirësi të tilla e pakësojnë efikasitetin e programeve të ndërmarrura prej organizatave të shoqërisë civile, ndërsa përfshirja e sektorit sipërmarrës dhe e mediave, në veprime të koordinuara me veprues të tjerë të rëndësishëm, është ende shumë e dobët.

***Organizatave ndërqeveritare, në përputhje me parimin e subsidiaritetit, janë të thirrura të aktualizojnë nisma të koordinuara për të luftuar rrjetet transkombëtare të krimit të organizuar që administrojnë trafikimin e personave njerëzorë dhe trafikun e paligjshëm të migrantëve. Bëhet i nevojshëm një bashkëpunim në nivele të ndryshme, pra që përfshin institucionet kombëtare dhe ndërkombëtare, ashtu si edhe organizatat e shoqërisë civile dhe botën e sipërmarrjes.***

Françesku, *Mesazh për kremtimin e Ditës XLVIII Botërore të Paqes 2015*, 8 dhjetor 2014

**39** Bashkëpunimi mes institucioneve kombëtare dhe ndërkombëtare është vendimtar dhe i rëndësishëm për t'i dhënë fund TP dhe për t'i bërë veprimet e të gjithëve më të shpejta e efikase, në vendet e prejardhjes, të tranzitit apo të destinacionit.

***Shumë më tepër mbetet për t'u bërë për të ngritur nivelin e vetëdijes së opinionit publik dhe për të krijuar një koordinim më të mirë përpjekjesh nga ana e qeverive, e autoriteteve gjyqësore, e atyre legjislativë dhe e vepruesve shoqërorë.***

Françesku, *Fjalim drejtuar pjesëmarrësve në Takimin mbi Trafikimin e Genieve Njerëzore të nxitur nga "RENATE"*, 7 nëntor 2016

Shtetet do të duhej t'i bashkëndanin informacionet e rëndësishme mbi TP me Shtetet e tjera dhe të zhvillonin përgjigje të përbashkëta në drejtim të parandalimit, mbrojtjes dhe procedimeve penale. Është i nevojshëm një bashkëpunim më i gjerë, ashtu siç është e nevojshme t'u jepet asistencë teknike dhe llojesh të tjera të gjitha vendeve të përkrahura nga rrugët e TP. Për të qenë efikas, bashkëpunimi dhe koordinimi duhet të përfshijnë edhe shoqërinë civile, organizatat profesionale dhe udhëheqësit fetarë, ashtu si edhe sektorin e sipërmarrjes dhe atë të medias.

***Bashkëpunimi mes Ipeshkvinjve dhe autoriteteve civile, secili sipas misionit të vet dhe natyrës së vet, me qëllim që të zbulohen praktikat më të mira për realizimin e kësaj detyre delikate, është një hap vendimtar për t'u siguruar se vullneti i qeverive të arrijë tek viktimat në mënyrë të drejtpërdrejtë e të menjëhershme, të vazhdueshme, efikase dhe konkrete.***

Françesku, *Mesazh drejtuar pjesëmarrësve në Konferencën mbi Trafikimin e Genieve Njerëzore të organizuar nga "Grupi Santa Marta"*, 28 tetor 2015

**40** Megjithëse Kisha Katolike ka bërë hapa të rëndësishëm përpara në koordinimin e frytshëm të institucioneve të veta, ka ende hapësirë për mirësimi. Brenda Kishës, një bashkëpunim më i ngushtë mes Konferencave Ipeshkvore, dioqezave, kongregatave rregulltare dhe organizatave katolike do t'i bënte më të frytshme nismat që tashmë janë në veprim kundër TP, dhe do të krijonte të tilla të reja. Do të ishte e dobishme edhe të punohej së bashku me konfesionet e tjera të krishtera dhe me bashkësitë e tyre, ashtu si edhe të bashkëpunohej me besimtarët e besimeve të tjera.

***Dialogu i mbështetur në respektin plot besim mund të sjellë fryte të mira që nga ana e tyre bëhen sythe miqësie dhe bashkëpunimi në shumë fusha, dhe sidomos në shërbimin ndaj të varfërve, ndaj të vegjëlve, ndaj të moshuarve, në mirëpritjen e migrantëve, në vëmendjen ndaj atyre që janë të përjashtuar. Mund të ecim së bashku duke u kujdesur për njëri-tjetrin dhe për botën e krijuar.***

*Françesku, Audiencia e përgjithshme ndërfaqetare me rastin e 50-vjetorit të shpalljes së Deklaratës Konciliare "Nostra Aetate", 28 tetor 2015*

Gjithashtu, bashkëpunimi mes Kishave në vendet e prejardhjes dhe të kthimit të të mbijetuarve të TP mund t'i përmirësojë programet e riintegrit.

## 9. MBËSHTETJA E TË MBIJETUARVE TË TRAFIKIMIT

**41** Ripërfshirja e të mbijetuarve të TP në shoqëri nuk është një punë e lehtë, duke pasur parasysh traumat që kanë pësuar.

***Detyra e vepruesve humanitarë (...) është që t'u ofrojnë viktimave mirëpritje, ngrohtësi njerëzore dhe mundësi lirimi.***

Francësku, *Fjalim drejtuar pjesëmarrësve në Konferencën Ndërkombëtare mbi Trafikimin e Personave*, 10 prill 2014

Nevojat e shumta janë fizike, psikologjike e shpirtërore; ata kanë nevojë të shërohen nga trauma, nga stigmatizimi dhe nga izolimi shoqëror.

***Bëhet fjalë, po e theksoj, për persona, që i bëjnë thirrje solidaritetit dhe asistencës, që kanë nevojë për ndërhyrje urgjente, por edhe, e sidomos, për mirëkuptim dhe për mirësi.***

Francësku, *Fjalim drejtuar pjesëmarrësve në plenaren e Këshillit Papnor të Bautorës për Migrantët dhe Itinerantët*, 24 maj 2013

Shërbimet shëndetësore shpesh kanë nevojë për formim specifik për identifikimin e simptomave dhe të kurave të pasojave të veçanta, por multidimensionale të TP. Vështirësitë praktike janë të shumta. Viktimat kanë nevojë për asistencë që të shlyejnë borxhe, të gjejnë vendbanim, të fitojnë kompetenca të reja, të gjejnë dhe të mbajnë një punë të përshtatshme. E megjithatë të mbijetuarit e TP priren të jenë të lënë pas dore, të dëbuar dhe të penalizuar – ose madje edhe të bëhen mish për top –, a thua se është i tyre faji për veprimtaritë degraduese që kanë qenë të detyruar të bëjnë.

**42** Shtetet do të duhej të zhvillonin ose të përmirësonin programe e mekanizma për të mbrojtur, rehabilituar dhe ripërfshirë viktimat, duke ua dorëzuar atyre burimet ekonomike të sekuestruara trafikantëve.

***Viktimat janë të parat që kanë nevojë për rehabilitim dhe për riintegrim në shoqëri; "E gjithë shoqëria është e thirrur të rritet në këtë vetëdije, veçanërisht për sa i përket***



***Legjislacionit kombëtar dhe ndërkombëtar, në mënyrë që trafikantët të mund t'i dorëzohen drejtësisë dhe fitimet e tyre të padrejta të përdoren për rehabilitimin e viktimave.***

Francesku, Fjalim në Samitin e gjyqtarëve mbi Trafikimin e Personave dhe Krimin e Organizuar, 3 qershor 2016, dhe Fjalim drejtuar pjesëmarrësve në seksionin plenar të Akademisë Papnore të Shkencave Shoqërore, 18 prill 2015

Një vendbanim dhe një punë e përshtatshme janë parësi të rëndësishme, ashtu si edhe qasja në shërbimet e ofruara nga asistentët shoqërorë, psikologët, analistët, avokatët, mjekët, personeli i ndihmës së shpejtë spitalore dhe profesionistët e tjerë. E gjithë kjo kërkon një formim të përshtatshëm që lejon të njihen dhe të marrin përgjigje nevojat komplekse të viktimave të tregtisë. Në qoftë se të mbijetuarit parapëlqejnë të rrinë në vendin e mbërritjes, ata do të kenë nevojë të marrin arsimimin superior dhe të hyjnë në programe që favorizojnë integrimin e tyre shoqëror dhe në punë.

***Përgjigjja bazë qëndron në krijimin e mundësive për një zhvillim njerëzor të tërësishëm, duke filluar me një edukim cilësor: kjo është pika kyçe, edukimi cilësor që prej fëmijërisë së parë, për të vazhduar e prodhuar më tej mundësi të reja rritjeje nëpërmjet punës. Edukimi dhe puna.***

Francesku, Videomesazh drejtuar pjesëmarrësve në Forumin Ndërkombëtar mbi Skllavërinë Moderne, 7 maj 2018

Duhet të përgatiten itinerare bashkimi familjar.

***Nuk duhet lënë pas dore absolutisht dimensionin familjar i procesit të integrimit.***

Francesku, Fjalim drejtuar pjesëmarrësve të Forumit Ndërkombëtar "Migrimet dhe Paqja", 21 shkurt 2017

Pavarësisht prej masave praktike të marrura, të mbijetuarit janë para së gjithash qenie njerëzore dhe duhet të ndihen gjithmonë të trajtuar me respektin më të madh.

**43** Kishat lokale, kongregatat rregulltare dhe organizatat me frymëzim katolik që u kanë dhënë fillesë programeve mbështetëse për viktimat e trafikimit, janë ftuar nga Papa Françesku që të shtojnë, të koordinojnë dhe të profesionalizojnë përpjekjet e tyre, duke u kujtuar aktorëve të tjerë përgjegjës të tyre.

***Do të doja të kujtoja punën e pamasë e të heshtur që shumë kongregata rregulltare, sidomos femërore, çojnë përpara prej shumë vitesh në dobi të viktimave.***

Franchesku, *Mesazh për kremtimin e Ditës XLVIII Botërore të Paqes 2015*, 8 dhjetor 2014

***Kisha angazhohet që të shtojë vetëdijen e nevojës në rritje për të ndihmuar viktimat e këtyre krimeve, duke i shoqëruar ato në një ecje riintegrimi në shoqëri dhe rikthimi të dinjitetit të tyre njerëzor. Kisha është mirënjohëse për çdo përpjekje të bërë për t'u çuar balsamin e mëshirës hyjnore atyre që vuajnë, sepse kjo përfaqëson edhe një hap thelbësor për shërimin dhe përtëritjen e shoqërisë në tërësinë e vet.***

Franchesku, *Fjalim drejtuar anëtarëve të "Santa Marta Group"*, 9 shkurt 2018

Vepruesit baritorë, që vihen në shërbim të viktimave të TP, duhet të kujtojnë gjithmonë rëndësinë e përkushtimit ndaj nevojave të tyre shpirtërore, duke njohur fuqinë kuruese të fesë, që për besimtarët katolikë vepron veçanërisht në Eukaristi dhe në sakramentin e pajtimit.

***Kisha (...) ka detyrën t'u tregojë të gjithëve rrugën drejt kthimit, që i bën të ndryshojnë vështrimin drejt të afërmit, të shohin në tjetrin, kushdo qoftë ai, një vëlla dhe një motër në njerëzim, të njohin dinjitetin përkatës në të vërtetën dhe në lirinë.***

Franchesku, *Mesazh për kremtimin e Ditës XLVIII Botërore të Paqes 2015*, 8 dhjetor 2014

Nëpërmjet dashurisë së mëshirshme të Hyjit, besimtarët mundën edhe të ndihmojnë në kthimin dhe në rehabilitimin e atyre që janë përgjegjës të TP.

***Ne të krishterët besojmë dhe dimë se ringjallja e Krishtit është shpresa e vërtetë e botës, ajo që nuk zhgënjën. Është forca e kokrrës së grurit, ajo e dashurisë që përkulet dhe dhurohet deri në fund, dhe që me të vërtetë e përtërin botën. Kjo forcë sjell fryt edhe sot në brazdat e historisë sonë, të karakterizuar nga shumë padrejtësi e dhuna. Sjell fryte shprese e dinjiteti aty ku ka mjerim e përjashtim, ku ka uri e mungon puna, në mes të të ikurve dhe refugjatëve – shumë herë të dëbuar prej kulturës aktuale të skartimit –, në mes të viktimave të narkotrafikut, të tregtisë së personave dhe të skllavërive të kohëve tona.***

Françesku, *Mesazhi Urbi et Orbi*, Pashkë 1 prill 2018

## 10. NXITJA E RIINTEGRIMIT

**44** Sapo viktimat e trafikimit lirohen dhe riatdhesohen në vendin e tyre të prejardhjes, duhet të fillojë një proces ripërfshirjeje; por programet kombëtare e ndërkombëtare për një gjë të tillë janë mjaft të rrallë. Ato pak që ekzistojnë përmbajnë vetëm një riatdhesim të shpejtë e të detyrueshëm, pa marrë parasysh pengesat ose madje edhe rreziqet e riatdhesimit. Vendet e destinacionit do të duhej t'i respektonin përgjegjësitë e veta ndaj viktimave të TP, duke u dhënë atyre një leje qëndrimi, asistencë psikologjike të specializuar dhe metoda alternative jetese, para një riatdhesimi të mundshëm.

**45** Kthimi i të mbijetuarve të TP në vendin e tyre të prejardhjes, qoftë ai riatdhesim apo transferim brenda vendit të tyre, nuk duhet të jetë kurrë i detyrueshëm. Sidoqoftë, të mbijetuarve të TP që zgjedhin të kthehen në shtëpi, duhet t'u jepet mbështetja më e madhe. "Në Vendet më pak të përparuara, prej të cilëve vjen pjesa më e madhe e viktimave, duhet të zhvillohen mekanizma më efikasë parandalimi të trafikimit të personave dhe rehabilitimi të viktimave të saj"<sup>23</sup>. Duhet të sigurohet një kthim i sigurt, një asistencë e përshtatshme në vendin e prejardhjes, dhe një mbrojtje e efikasë kundër një rënijeje të mundshme përsëri në rrjetet e tregtisë apo një veprimi të mundshëm raprezaljeje apo kërcënimi nga ana e trafikantëve. Duhet vënë në dispozicion shërbime në mbështetje të të mbijetuarve dhe të familjeve të tyre. Formimi për punë dhe hyrja në punë janë shumë të rëndësishme.

***Për ata që vendosin të kthehen në atdhe, theksoj mundësinë për të zhvilluar programe riintegrimi në punë dhe në shoqëri.***

Françesku, *Mesazh për Ditën Botërore të Migrantit dhe të Refugjatit 2018*, 14 janar 2018

Pa një ripërfshirje të plotë, cikli i tmerrshëm i TP nuk do të ndërpritet; dhe nuk do të mbarojë stigma e vuajtja. Të mbijetuarit e TP nuk do ta riftojnë integritetin e tyre, as nuk do t'u jepet atyre mundësia për të jetuar një jetë të denjë për të drejtat dhe dinjitetin që ata kanë.

---

<sup>23</sup> Gjon Pali II, *Letër drejtuar arqipeshkvit Jean-Louis Touran me rastin e Konferencës Ndërkombëtare mbi temën: "Skllavëria e shekullit XXI: dimensionet e drejtave njerëzore në tregtinë e personave"*, 15 maj 2002

**46** Programet e ripërfshirjes për të mbijetuarit e TP duhet të përfshijnë gjithmonë dimensionin shpirtëror si element thelbësor të zhvillimit njerëzor të tërësishëm, që përfaqëson qëllimin e tyre të fundit. Ky dimension shpirtëror duhet të integrohet krejtësisht në veprimin e çdo organizate me frymëzim katolik apo konfesional që me zemërgjerësi vihet në shërbim të të mbijetuarve të TP.

## PËRFUNDIM

---

**47** «Gjithmonë më ka shkaktuar dhimbje situata e atyre që janë objekt i formave të trafikimit të personave. Do të doja që të dëgjohej britma e Hyjit që na kërkon ndihmë të gjithëve ne: "Ku është vëllai yt?" (Zan 4,9). Ku është vëllai yt skllav? (...) Ka shumë bashkëpunime në faj. Pyetja është për të gjithë!»<sup>24</sup>.

Ati i Shenjtë lutet që "Hyji të mund t'i lirojë të gjithë ata që janë kërcënuar, plagosur apo keqtrajtuar prej trafikimit dhe t'u japë ngushëllim atyre që i kanë mbijetuar kësaj mizorie". Prandaj drejtoj një thirrje "që të gjithë ne të mund të hapim sytë, të shohim mjerimin e atyre që janë krejtësisht të privuar nga dinjiteti i tyre e liria e tyre, dhe të dëgjojmë britmën e tyre për ndihmë"<sup>25</sup>.

Urojmë që, në harmoni me inkurajimet dhe nxitjet e lartpërmendura të Papës Françesku, këto *Orientime Britore* të mund të shërbejnë si kuadër referimi për të projektuar, zhvilluar, realizuar dhe verifikuar gjithë atë gamë veprimesh që i vë vetes si objektiv të rëndësishëm e urgjent mposhtjen e TP. Edhe pse qëllimi i drejtpërdrejtë është lirimi dhe reabilitimi i të gjithë atyre që janë zënë në kurthën e TP, qëllimi i fundit është ai që të shpërbëhet dhe të zhduket kjo sipërmarrje, tejet e mbrapshtë dhe e keqe, e përbërë nga mashtrimi, tallja, sundimi dhe shfrytëzimi. "Kjo punë tejet e madhe, që kërkon guxim, durim dhe qëndresë, ka nevojë për një përpjekje të përbashkët e globale nga ana e aktorëve të ndryshëm që përbëjnë shoqërinë. Edhe Kishat duhet t'ia kushtojnë angazhimin e tyre kësaj"<sup>26</sup>.

---

**24** Françesku, *Nxitiya apostolike Evangelii Gaudium*, 24 nëntor 2013, 211

**25** Françesku, *Mesazhi drejtuar Konferencës Ileshkvore të Anglisë dhe Uellsit për Ditën për jetën*, 17 qershor 2018

**26** Françesku, *Videomesazh drejtuar pjesëmarrësve në Forumin Ndërkombëtar mbi Skllavërinë Moderne*, 7 maj 2018

# LUTJE

---

*O Atë i Gjithëpushtetshëm, po të falënderojmë për shembullin e Shenjtes Jozefina Bakita.*

*Shenjtja Jozefina Bakita, të kanë bërë skllave kur ishe fëmijë; të kanë shitur e blerë; të kanë trajtuar me brutalitet.*

*Po të lutemi, ndërmjetëso për të gjithë ata që janë robër të trafikimit dhe të skllavërisë, që torturuesit t'u kthejnë atyre lirinë dhe kjo e keqe të zhduket nga fytyra e tokës.*

*Shenjtja Jozefina Bakita, kur t'u ridha liria, nuk lejove që mundimet e pësuar ta përcaktonin jetën tënde. Zgjodhe rrugën e mirësisë dhe të bujarisë.*

*Ndihmoji ata që janë të verbuar nga grykësia e nga lakmia dhe shkelin të drejtat njerëzore e dinjitetin e vëllezërve e motrave të tyre. Ndihmoji t'i këpusin zinxhirët e urrejtjes, të rigjejnë njerëzimin e tyre, dhe të imitojnë mirësinë e bujarinë tënde.*

*Shumë e dashura Shenjtja Jozefina Bakita, liria jote të drejt Krishtit e drejt Kishës. Hyji pastaj të thirri në jetën rregulltare si rregulltare kanosiane. Qe një shembull dashurie të krishterë, mëshire dhe butësie të gëzueshme në thirrjen tënde.*

*Na ndihmo të imitojmë shembullin tënd, veçanërisht kur jemi të tunduar t'i shpërfillim të tjerët, të mos u shkojmë në ndihmë, të mos i pranojmë ose madje edhe t'i keqtrajtojmë e shfrytëzojmë.*

*Ndërmjetëso për ne që prania e gëzueshme e Krishtit t'i mbushë zemrat tona siç ka mbushur tënden.*

*O Hyj i dashurisë, bëj që të shkëlqejë mbi këtë botë të munduar drita e mëshirës Tënde.*

*Bëj që të hyjë aty ku errësira është më e dendur.*

*Sillu shpëtim të pafajshëmve që pësojnë cenime e abuzime. Ktheji të këqijtë që i shtypin dhe i mbajnë robër.*

*Dhuroju të gjithëve ne forcën që të rritemi në lirinë e vërtetë të dashurisë për Ty, për të afërmin dhe për shtëpinë tonë të përbashkët.*

*Amen*



MIGRANTS  
REFUGEES

MIGRANTS & REFUGEES SECTION  
INTEGRAL HUMAN DEVELOPMENT  
PALAZZO SAN CALISTO  
00120 VATICAN CITY

